



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Komisioni për Politikën e Jashtme

RAPORT

PËR

“RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM TEKNIK 2017 PËR PROJEKTIN “ZHVILLIM I QËNDRUESHËM I ZONAVE RURALE””

Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2017 për projektin “Zhvillim i Qëndrueshëm i Zonave Rurale””.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm znj. Ermira Gjeci, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si edhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PËRMBAJTJA E TIJ

Qëllimi kryesor i kësaj marrëveshjeje është financimi i projektit “Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale” duke forcuar më tej bashkëpunimin financiar midis Shqipërisë dhe Gjermanisë me qëllim kontributin e mëtejshëm të Gjermanisë në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë.

Duke marrë në konsideratë nevojën për zhvillim të qëndrueshëm në zonat rurale të Republikës të Shqipërisë si dhe rëndësinë e mbështetjes teknike, hyrja në fuqi e kësaj

marrëveshjeje paraqet interes në aspektin ekonomik e social. Në kuadër të këtij projekti, Republikës të Shqipërisë do t'i vihen në dispozicion shërbime në personel dhe materiale si dhe, eventualisht, kontribute financimi (grante) me një vlerë të prej dy milionë euro. Përfituesi final do të jetë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e cila edhe ngarkohet për zbatimin e marrëveshjes.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, Republika e Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen në zëra më vete, që të sigurojë zbatimin e vazhdueshëm të projektit, si dhe kujdeset për kryerjen e shërbimeve të nevojshme nga institucionet e ngarkuara për zbatimin e tij. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural merr përsipër të përballojë pagesën e TVSH-së (rreth 200 000 euro), brenda buxhetit të miratuar të MBZHR-së.

Hollësitat e projektit si dhe ato mbi detyrimet dhe shërbimet që duhet të kryhen do të përcaktohen në kontrata të veçanta zbatimi dhe financimi, të cilat do të lidhen ndërmjet institucioneve që janë ngarkuar ose do të ngarkohen me zbatimin e projektit.

III. PËRFUNDIM

Në aspektin ligjor, vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Së fundi, si relator vlerësoj rëndësinë e miratimit të këtij projektligji dhe u kërkoj kolegëve ta miratojmë atë në Komision.

RELATORI

KRYETARI

JURGYS ÇYRBJA

ULSI MANJA